



  
**AMFORA**

**PARIMET  
EDITORIALE**

**PARIMET EDITORIALE  
DHE  
STANDARDET PROFESIONALE  
AMFORA MEDIA GROUP**

*Parimet Editoriale dhe Standardet Profesionale të Amfora Media Group janë hartuar bazuar në misionin tonë për informimin e publikut, duke u konsultuar edhe me modelet e aplikuara në mediat vendase dhe ato ndërkombëtare. Për një njohje më të gjerë me standardet tona profesionale lexoni Kodin Etik të miratuar nga ana jonë.*

**Qershor, 2020**

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>HYRJE</b> .....	2
<b>1. Saktësia</b> .....	2
<b>2. Paanësia dhe ndershmëria</b> .....	3
<b>3. Pavarësia</b> .....	3
<b>4. Integriteti editorial</b> .....	4
<b>5. Kontrolli i fakteve</b> .....	4
<b>6. Përgjegjësia</b> .....	4
<b>7. Privatësia</b> .....	5
<b>8. Sjellja profesionale</b> .....	5
<b>9. Dëmi dhe ofendimi</b> .....	5
<b>10. Llogaridhënia</b> .....	6
<b>11. Gjuha</b> .....	6
<b>12. Të drejtat e pronësisë intelektuale</b> .....	6

## HYRJE

Parimet editoriale dhe standardet profesionale janë politika të qëndrueshme dhe të vlefshme, që rregullojnë veprimtarinë krijuese në Amfora Media Group në përmbushje të misionit për informimin e publikut. Këto parime dhe standarde janë të vlefshme edhe në rastet e ndryshimeve të pritshme të teknologjisë së krijimit dhe publikimit.

Ato drejtojnë gazetarin dhe redaktorin lidhur me mënyrat sesi ai/ajo siguron informacionin, verifikimin e burimeve, sigurimin e dokumentacionit si dhe shkrimin e lajmit. Ato janë gjithashtu një mburojë etike për ta, në rastet në të cilat mund të ngrihen pyetje lidhur me sigurimin e informacionit apo mënyrën e raportimit.

Për të përmbushur me sa më profesionalizëm misionin tonë ne kemi hartuar Kodin Etik, në të cilin kemi shpjeguar me detaje standardet profesionale që duhet t'i përmbahen reporterët, gazetarët, krijuesit dhe redaktorët e Amfora Media Group.

Ne jemi të gatshtëm që në të gjithë procesin e vlerësimit, saktësimit dhe të zbatimit të standardeve editoriale dhe profesionale, të gjykojmë në mënyrë profesionale përmbajtjen e krijimeve tona dhe të vendosim vetëm mbi bazën e gjykimit profesional.

Amfora Media Group është e pavarur dhe nuk lejon asnjë institucion shtetëror, qeveri, parti politike apo interes komercial që të influencojë parimet editoriale. Ne nuk mbështesim asnjë parti politike, kauzë kombëtare apo fetare, ndërkohë që raportojmë mbi një shumëllojshmëri opinionesh politike në mënyrë të ndershme dhe të balancuar. Artikujt e opinioneve janë të ndara nga lajmet, reportazhet, analizat dhe investigimet.

Parimet e përgjithshme mbi të cilat bazohen parimet editoriale dhe standardet profesionale të Amfora Media Group përmbledhen si më poshtë:

### 1. Saktësia

*Saktësia është e shenjtë dhe nuk duhet të sakrifikohet për shkak të shpejtësisë,  
pasi integriteti i krijimeve tona varet shumë nga saktësia e tyre.*

Amfora Media Group është e angazhuar të garantojë se çdo publikim që i përcillet publikut do të paraqitet saktësisht dhe në kontekstin e tij. Ne garantojmë se të gjitha programet që përmbajnë

editoriale, analiza, komente dhe këndvështrime të ndryshme, do të vlerësohen sipas së njëjtave standardeve që karakterizojnë raportimin e lajmeve.

Gazetari ka për detyrë të mbledhë informacionet me kujdesin e duhur, t'i verifikojë ato dhe t'u kushtojë vëmendjen e nevojshme.

Informacioni i pavërtetë mund të shkatërrojë besueshmërinë e Amfora Media Group dhe asnjëherë nuk duhet të përdoret detyra si mjet apo formë manipulimi për qëllime të caktuara, të ndikojë apo të ndryshojë zhvillimin e ngjarjeve, në raport me audiencën.

Redaktorët duhet t'i lexojnë të gjitha informacionet për t'u siguruar që ato janë të vërteta dhe gazetarët duhet të kërkojnë të paktën dy burime të pavarura për të konfirmuar çdo fakt. Burimet duhet të jenë të bazuara në fakte dhe jo në thashetheme.

## 2. Paanësia dhe ndershmëria

*Paanësia editoriale dhe ndershmëria duhet të shërbejnë për të krijuar besimin që*

*vendimmarrja e redaktorëve dhe gazetarëve nuk influencohet nga interesat politike, komerciale ose private.*

Paanësia është një vlerë themelore e të gjitha krijimeve tona, misioni i të cilave është informimi objektiv i publikut. Amfora Media Group nuk do të marrë në konsideratë asnjë krijim nëse vihet re se përmbajtja e tyre ka fakte të trajtuara në mënyrë të njëanshme dhe manipuluese, apo fakte të pa dokumentuara dhe pasaktësi.

Raportimi duhet të marrë parasysh të gjithë personat, institucionet, çështjet dhe ngjarjet në mënyrë të paanshme dhe etike. Raportimi duhet të shmangë çdo gjë që shkakton dyshime të arsyeshme lidhur me paanësinë e gazetarit ose të medias, apo çdo gjë që mund të krijojë idenë se gazetari ose media janë të ekspozuar ndaj presionit të një grupi të caktuar, qoftë ai ideologjik, politik, financiar, me natyrë sociale, fetare apo kulturore.

Gazetari mund të shprehë një gjykim profesional, në bazë të fakteve që kanë lidhje me çështjen, por jo një mendim personal që shpreh pikëpamje të njëanshme për çështjen, por ata dhe redaktorët nuk mund të fshehin ose të shpërfillin informacione me të cilat ata nuk pajtohen personalisht.

## 3. Pavarësia

*Standardi i pavarësisë respektohet në Amfora Media Group*

*dhe shtrihet përtej idesë që lajmi apo informacioni duhet të jenë neutral.*

Gazetarët dhe redaktorët në asnjë rast nuk duhet të krijojnë përshtypjet e tyre në bazë të paragjykitimit apo të lejojnë vënien në pikëpyetje të integritetit të tyre profesional.

Gazetarët duhet t'i përmbahen në çdo situatë parimit të autonomisë dhe të pavarësisë së krijimeve të Amfora Media Group, duke u mbështetur në parimet editoriale dhe standardet profesionale, edhe në rastet kur janë bashkëprodhime apo prodhime të palëve të treta.

#### 4. Integriteti editorial

*Reputacioni i Amfora Media Group mbështetet fort në besimin e publikut për integritetin editorial të përmbajtjes së krijimeve dhe publikimeve tona.*

Për të ruajtur këtë besim Amfora Media Group është përgjegjëse për mbrojtjen e veprimtarisë krijuese dhe editoriale nga presioni politik ose ndikimi i papërshtatshëm nga reklamuesit apo burime të tjera. Të gjithë punonjësit janë përgjegjës për reputacionin e institucionit.

#### 5. Kontrolli i fakteve

*Gazetarët dhe redaktorët e Amfora Media Group duhet të respektojnë rregullin bazë profesional: Kontrolli i të gjitha fakteve para se të publikohen.*

Nëse nuk është i mundur verifikimi, atëherë duhet të deklarohet burimi nga është marrë informacioni dhe nëse burimi është i besueshëm, por nuk dëshiron të bëhet publik, atëherë mund të përdoren disa fraza, të tilla si: “nga burime të besueshme”; “nga burime të verifikuara”; “nga burime të mirë informuara”, “nga burime diplomatike”, “nga burime të afërta me...”, etj.

Krijimet e Amfora Media Group si rregull duhet të shmangin përdorimin e frazave të tipit: “thuhet se...”; “flitet se...”; “kemi dëgjuar se...”, etj. Kujdes i veçantë duhet treguar kur përdoren burime të pa autorizuara nga interneti dhe para se të transmetohen duhet të kontrollohen të gjitha faktet.

#### 6. Përgjegjësia

*Qëllimi kryesor i mbledhjes së lajmeve dhe publikimit të tyre nga Amfora Media Group është që të sigurojë një qasje sa më të gjerë të mundshme dhe t'u japë mundësinë përdoruesve për të formuar opinionet e tyre për çështje të caktuara.*

Gazetarët dhe redaktorët nuk duhet të abuzojnë me pozitën e tyre duke përhapur lajme të rreme apo të manipuluar. Përgjegjësia përfshin edhe ndjeshmërinë që mund të tregohet apo krijimin e një distance të caktuar nga materialet që shpërndahen nga agjencitë e Marrëdhënieve me Publikun, që synojnë krijimin e imazhit dhe famës për personalitete të caktuara.

## 7. Privatësia

*Amfora Media Group respekton privatësinë dhe nuk publikon komunikime private, përveç rasteve kur ka një interes të qartë publik.*

Në raportimet e tyre, gazetarët dhe redaktorët e Amfora Media Group duhet të respektojnë integritetin e individëve dhe të drejtën e tyre për privatësi. Personave të përfshirë/përmendur apo që lidhen me krijimet tona në rastin më të parë të mundshëm duhet t'u jepet mundësia për t'u shprehur apo përgjigjur.

## 8. Sjellja profesionale

*Gazetarët dhe redaktorët e Amfora Media Group duhet të bëjnë përpjekje maksimale për të zbatuar standarde të larta profesionale.*

Amfora Media Group ndalon publikimin e çdo lloj krijimi nëse ka arsye të besohet se një punonjës ka thyer normat bazë të sjelljes profesionale.

Shembuj të sjelljes joprofesionale konsiderohen:

- Fabrikimi i informacionit ose mbledhja e tij nëpërmjet ryshfetit ose kanosjes;
- Mungesa e humanizmit ndaj tragjedi apo zisë njerëzore;
- Përdorimi i materialeve të tjerëve pa respektuar të drejtën e autorit dhe të transmetimit;
- Konflike të interesi të shfaqura nëpërmjet pranimit të ryshfeteve, dhuratave, favoreve apo kompensimeve nga ata që mund të jenë të interesuar të ndikojnë në prodhimin e programit;
- Nuk përfshin të gjitha fakte e rëndësishme;
- Përfshin fakte të pa rëndësishme dhe shpërfill ato më të rëndësishmet;
- Përdor shprehje ose skema që tregojnë anësi;
- Mashtron me qëllim shikuesit dhe dëgjuesit.

## 9. Dëmi dhe ofendimi

*Gazetarët dhe redaktorët duhet të tregojnë ndjeshmëri ndaj grupeve vulnerabël, fëmijëve si dhe viktimave të traumës.*

Gazetarët duhet të respektojnë gjithmonë prezumimin e pafajësisë dhe duhet të rezistojnë ta përshkruajnë dikë si kriminel përpara vendimit përfundimtar nga gjykata. Gjatë raportimit të krimeve të minorenëve dhe procedurave të gjykatave të minorenëve, gazetarët dhe redaktorët duhet të ushtrojnë vetëpërmbytje për hir të konsideratës për të ardhmen e të rinjve në fjalë.

Ky rekomandim aplikohet edhe për raportimet mbi viktimat e migrimit dhe trafikimit të jashtëligjshëm njerëzor. Gazetarët nuk duhet të përdorin institucionet shtetërore si i vetmi burim dhe duhet të mbrojnë identitetin e dëshmitarëve të mbrojtur.

## 10. Llogaridhënia

*Gazetarët dhe redaktorët e Amfora Media Group duhet të jetë të hapur për t'u angazhuar me audiencën dhe për t'u marrë me komentet dhe ankesat legjitime.*

Amfora Media Group do të publikojë një korrigjim të qartë dhe përshtatshëm kur demonstron se ka botuar një informacion të pasaktë dhe të shtrembëruar. Amfora Media Group duhet të kërkojë ndjesë dhe të ofrojë dëmshpërblim të përshtatshëm kur është e nevojshme. Pala e kritikuar gjithmonë duhet të ketë të drejtën për t'u përgjigjur.

## 11. Gjuha

*Gazetarët dhe redaktorët e Amfora Media Group duhet t'i kushtojnë kujdes të veçantë gjuhës shqipe.*

Gjuha duhet të jetë e qartë dhe e thjeshtë, duke shmangur teprimet dhe paqartësitë. Gazetarët dhe redaktorët janë të detyruar të përdorin stilin letrar të gjuhës shqipe.

Amfora Media Group nuk lejon përdorimin e shprehjeve vulgare apo përdorimin e gjuhës që nuk është në përputhje me normat e pranuar shoqërore. Megjithatë ne duhet të jemi të vetëdijshëm se pranimi publik në lidhje me shprehje të caktuara është në ndryshim të vazhdueshëm.

## 12. Të drejtat e pronësisë intelektuale

*Gazetari duhet të respektojë të drejtat e autorit dhe do të nxisë kolegët të respektojnë të drejtën e autorit të tjerëve në çfarëdo fushe krijimtarie sepse plagjiatura është e papranueshme.*

Gazetarët dhe redaktorët e Amfora Media Group duhet t'ia atribuojnë informacionin që përdorin burimit origjinal dhe në rastet kur i referohemi burimeve të tjera mediatike ato duhen cituar.



---

AMFORA MEDIA GROUP DHE PUNONJËSIT E SAJ ZOTOHEN PËR ZBATIMIN ME  
PËRPIKMËRI TË PARIMEVE EDITORIALE DHE STANDARDEVE PROFESIONALE.

*Geri Emiri,*

*Drejtues i Amfora Media Group*

**AMFORA MEDIA GROUP  
N IPT: NO1726504U  
DURRES, SHQIPERI  
WWW.AMFORA.AL**